



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë më _____.____.2024

V E N D I M

Nr. 97, datë 29.02.2024

PËR

**PEZULLIMIN E PROCEDIMIT DISIPLINOR NR. 1/2024, TË FILLUAR NDAJ
MAGJISTRATES, ZNJ. {...}, ME FUNKSION GJYQTARE PRANË GJYKATËS SË
SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM TIRANË**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, më datë 29.02.2024, mori në shqyrtim aktet e procedimit disiplinor nr. 1/2024 që i përket:

KËRKUES: Inspektori i Lartë i Drejtësisë, përfaqësuar me autorizim nga z. Eugen Nasufi.

SUBJEKT I PROCEDIMIT: Magjistratja {...},

OBJEKTI I KËRKESËS:

1. Fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistrates znj. {...}, me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë
2. Propozimin për caktimin e masës disiplinore :
- “Shkarkim nga detyra”

BAZA LIGJORE: Neni 138; neni 102, pika 1, shkronja “d”; neni 111 i Ligjit nr. 96/2016, “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe të Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Në seancë dëgjimore, pas shqyrtimit të çështjes sipas parashikimeve të nenit 142 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, mbi propozimin e relatores znj. Gentiana Muçaj, Këshilli

V Ë R E N:

1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë, me shkresën nr. 2292/30 prot., datë 12.01.2024 ka depozituar për shqyrtim pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, me datë 16.01.2024, kërkesën me objekt *Fillimin e procedimit disiplinor ndaj magistrates znj. {...} me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.*

2. Kërkesa për fillimin e procedimit disiplinor, mbështetet në nenin 194 të Ligjit nr. 115/2016, "Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë", të ndryshuar, dhe në nenin 138 të Ligjit nr. 96/2016, "Për Statusin e Gjyqtarëve dhe të Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, për shkelje disiplinore të parashikuar nga neni 102, pika 1, shkronja "d" i Ligjit nr. 96/2016.

3. Në kërkesën për fillimin e procedimit disiplinor, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka paraqitur propozimin për caktimin e masës disiplinore "Shkarkim nga detyra" ndaj magistrates znj. {...} të parashikuar nga nenet 105, pika 1, shkronja *dh* dhe 111 të Ligjit nr. 96/2016 "Për Statusin e Gjyqtarëve dhe të Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

I. FAKTET DHE RRETHANAT E PRETENDUARA OBJEKT TË PROCEDIMIT DISIPLINOR

4. Pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është regjistruar me nr. 3570 prot., datë 13.09.2021, ankesa e shtetases {...}, në lidhje me zvarritjen e dorëzimit të vendimit gjyqësor të arsyetuar pas përfundimit të procesit gjyqësor nga gjyqtar {...} e cila ushtron funksionin e saj pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Në ankesën e saj, ankuesja parashtron se ka qenë me cilësinë e palës paditëse në një process gjyqësor me objekt dhënie detyrimi ushqimor, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë të gjykuar nga gjyqtarja {...}. Gjyqtarja pasi ka përfunduar gjykimi, nuk ka dorëzuar dhe ka zvarritur në mënyrë të pajustificuar arsyetimin e vendimit gjyqësor. Sipas ankuses, i është kërkuar disa herë gjyqtarës {...}, që t'i vendoste në dispozicion vendimin gjyqësor të arsyetuar, ndërkohë që është përcjellë nga gjyqtarja, e cila nuk ka përmbushur detyrimin që e ngarkon ligji.

5. Inspektori i Lartë i Drejtësisë, nga shqyrtimi fillestar i ankesës ka konstatuar se ajo nuk përmbante fakte të qarta dhe të mjaftueshme, si dhe nuk ishte shoqëruar me prova të cilat të justifikonin fillimin e hetimit disiplinor sipas kërkesave të nenit 123, pika 1, të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, i cili parashikon se Inspektori i Lartë i Drejtësisë fillon hetimin disiplinor nëse ka dyshime të arsyeshme se shkelja mund të jetë kryer bazuar në faktet dhe provat e mbledhura të cilat justifikojnë fillimin e hetimit disiplinor.

5.2 Me qëllim verifikimin e ankesës së paraqitur nga shtetasja {...}, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, me Vendimin nr. 3570/3 prot., datë 23.12.2021, ka vendosur verifikimin e pretendimeve të paraqitura nga shtetasja {...}, duke urdhëruar marrjen e të dhënave shtesë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në mbështetje të neneve 121, pika 2, shkronja “b” dhe 122 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, konkretisht: (i) kopje e vendimit nr. 2551, datë 22.04.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; (ii) fleta e regjistrimit të dorëzimit të vendimit të arsyetuar në kryesekretari; (iii) data e komunikimit të vendimit palëve ndërgjyqëse; si dhe (iv) shkaqet që kanë sjellë në dorëzimin e vendimit të sipërcituar në kryesekretari, përtej afatit ligjor.

6. Sipas Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, nga shqyrtimi i të dhënave të administruara në procesin e verifikimit, ka rezultuar se çështja civile me nr. 3372 akti, datë regjistrimi 21.01.2020, me palë paditëse {...} dhe palë e paditur Qamil Lami, me objekt “Pension ushqimor...etj.”, ka përfunduar me vendimin nr. 2551, datë 22.04.2021, të dhënë nga gjyqtarja e çështjes {...}. Për gjykimin e kësaj çështjeje janë zhvilluar 10 seanca përgatitore/gjyqësore dhe gjykimi ka përfunduar në datë 22.04.2021, me një kohëzgjatje prej 1 (një) vit e 3 (tre) muaj. Ndërsa, dosja gjyqësore, së bashku me vendimin e arsyetuar është dorëzuar në sekretari në datën 14.10.2021, me një afat prej 5 muaj e 22 ditë në kundërshtim me nenin 308/2 të Kodit të Procedurës Civile i cili parashikon se : *“Gjykata mund të shpallë vetëm dispozitivin e vendimit, duke e dorëzuar atë të arsyetuar në sekretari jo më vonë se njëzet ditë ose të shtyjë shpalljen e arsyetuar të vendimit, deri në njëzet ditë. Arsyetimi i vendimit bëhet nga kryetari i seancës, përveç kur ai del kundër”*. Sipas këtij parashikimi ligjor, gjyqtari në gjykatën e shkallës së parë ka detyrimin që vendimin përfundimtar ta dorëzojë të arsyetuar në sekretari jo më vonë se 20 ditë nga shpallja. Në referim të këtij përcaktimi ligjor rezulton, se gjyqtarja {...}, vendimin nr. 2551, datë 22.04.2021, e kishte depozituar të arsyetuar në sekretari në datën 14.10.2021.

7. Në vijim, nga të dhënat e administruara nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë gjatë procesit të verifikimit, ka rezultuar gjithashtu se, për periudhën 01.04.2021-31.10.2021, gjyqtarja {...} ka gjykuar 166 çështje civile, nga të cilat 159 çështje familjare dhe 7 kërkesa civile. Për periudhën 06.02.2021 deri me datë 19.02.2021 (sipas vërtetimit të qendrës shëndetësore) ka qenë e vetëizoluar për shkak të infektimit me sëmundjen e Sars-Cov-2, gjithashtu me raport mjekësor nga data 19.02.2021 - 06.03.2021. Ndërkohë nga data 08.03.2021 - 23.03.2021 ka qenë me leje vjetore. Ndërsa brenda periudhës 01.04.2021 - 31.10.2021, gjyqtarja {...} nuk është paraqitur në punë për arsye të justifikuar gjithsej 23 ditë, konkretisht në datat 02.06.2021 - 05.06.2021; 10.06.2021 - 12.06.2021; 02.08.2021 - 13.08.2021 (leje vjetore) dhe 24.08.2021 - 31.08.2021 (leje vjetore).

7.1 Ndërkohë për periudhën 01.04.2021 - 22.04.2021 (*data e shpalljes të vendimit nr. 2551, datë 22.04.2021*), nga gjyqtarja {...} janë shpallur ndër të tjera dhe janë dorëzuar të arsyetuar në sekretarinë e gjykatës, vendimet si më poshtë:

1. Vendimi nr. 1977, datë 01.04.2021 (*lëshim i urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes*), dorëzuar i arsyetuar në datë 16.06.2021, për një afat 2 muaj dhe 15 ditë;
2. Vendimi nr. 1978, datë 01.04.2021 (*lëshim i urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes*), dorëzuar i arsyetuar në datë 17.03.2022, për një afat 11 muaj dhe 16 ditë;
3. Vendimi nr. 1979, datë 01.04.2021 (*lëshim i urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes*), dorëzuar i arsyetuar në datë 17.03.2022, për një afat 11 muaj dhe 16 ditë;
4. Vendimi nr. 2028, datë 02.04.2021 (*zgjidhje martese me marrëveshje*), dorëzuar i arsyetuar në datë 12.08.2021, për një afat 4 muaj dhe 10 ditë;
5. Vendimi nr. 2192, datë 09.04.2021 (*padi për zgjidhje martese*), dorëzuar i arsyetuar në datë 27.04.2021, për një afat 18 ditë;
6. Vendimi nr. 2193, datë 09.04.2021 (*ndryshim vendimi familjare*), dorëzuar i arsyetuar në datë 17.06.2021, për një afat 2 muaj dhe 8 ditë;
7. Vendimi nr. 2194, datë 09.04.2021 (*lëshim i urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes*), dorëzuar i arsyetuar në datë 24.12.2021, për një afat 8 muaj dhe 15 ditë;
8. Vendimi nr. 2195, datë 09.04.2021 (*lëshim i urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes*), dorëzuar i arsyetuar në datë 24.12.2021, për një afat 8 muaj dhe 15 ditë;
9. Vendimi nr. 2229, datë 12.04.2021, (*padi për zgjidhje martese*) dorëzuar i arsyetuar në datë 11.06.2021, për një afat 1 muaj dhe 29 ditë;
10. Vendimi nr. 2230, datë 12.04.2021, (*padi për zgjidhje martese*) dorëzuar i arsyetuar në datë 06.05.2021, për një afat 24 ditë;
11. Vendimi nr. 2231, datë 12.04.2021 (*lëshim i urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes*), dorëzuar i arsyetuar në datë 10.05.2021, për një afat 28 ditë;
12. Vendimi nr. 2319, datë 14.04.2021 (*lëshim i urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes*), dorëzuar i arsyetuar në datë 24.12.2021, për një afat 8 muaj dhe 10 ditë;
13. Vendimi nr. 2385, datë 16.04.2021 (*lëshim i urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes*), dorëzuar i arsyetuar në datë 24.12.2021, për një afat 8 muaj dhe 8 ditë;
14. Vendimi nr. 2430, datë 19.04.2021 (*lëshim i urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes*), dorëzuar i arsyetuar në datë 06.01.2022, për një afat 8 muaj dhe 17 ditë;
15. Vendimi nr. 2478, datë 20.04.2021 (*zgjidhje martese me marrëveshje*), dorëzuar i arsyetuar në datë 17.05.2021, për një afat 27 ditë;
16. Vendimi nr. 2479, datë 20.04.2021, (*lëshim urdhër mbrojtje*) dorëzuar i arsyetuar në datë 17.05.2021, për një afat 27 ditë;
17. Vendimi nr. 2516, datë 21.04.2021 (*padi për zgjidhje martese*), dorëzuar i arsyetuar në datë 21.10.2021, për një afat 6 muaj;
18. Vendimi nr. 2517, datë 21.04.2021 (*padi për zgjidhje martese*), dorëzuar i arsyetuar në datë 28.04.2021, për një afat 7 ditë;
19. Vendimi nr. 2518, datë 21.04.2021, (*lëshim i urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes*), dorëzuar i arsyetuar në datë 31.12.2021, për një afat 8 muaj dhe 10 ditë;

20. Vendimi nr. 2251, datë 22.04.2021 (*padi për pension ushqimor*), dorëzuar i arsyetuar në datë 14.10.2021, për një afat 5 muaj e 22 ditë, i cili është dhe vendimi objekt ankese.

7.2 Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka konstatuar se, pavarësisht se verifikimi i ankesës kishte filluar lidhur me pretendimin e ankueses {...}, për vonesa nga ana e gjyqtarës {...}, në zbardhjen dhe dorëzimin e arsyetuar në sekretari të vendimit nr. 2551, datë 14.04.2021, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, nga verifikimi rezultoi se kjo gjyqtare kishte një numër të konsiderueshëm të vendimeve gjyqësore që janë zbardhur dhe dorëzuar me vonesë në sekretarinë e gjykatës.

7.2.1 Nga 20 vendime gjyqësore të dhëna për periudhën 01.04.2021 - 22.04.2021, vetëm dy vendime gjyqësore janë dorëzuar të arsyetuar në sekretari brenda afatit ligjor prej 20 ditësh, ndërkohë për 18 (vendime) të tjera rezulton se ato janë dorëzuar përtej afatit ligjor që shkon nga 7 (ditë) me vonesë (*vendimi nr. 2478, datë 20.04.2021*), deri në 331 ditë me vonesë (*vendimi nr. 2229, datë 12.04.2021*).

7.3 Sipas nenit 443 të Kodit të Procedurës Civile, afati i ankimit kundër vendimeve të dhëna nga gjykata e shkallës së parë është 15 ditë. Ndërkohë sipas nenit 444 të Kodit të Procedurës Civile, afatet e ankimit janë të prera dhe fillojnë nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit të arsyetuar. Por ky parashikim ligjor që lidhet me të drejtën pozitive të ankimit, që nuk e shuan të drejtën e ankimit për shkak të moszbardhjes së vendimit brenda afatit procedural që parashikon ankimin kundër tij, nuk do të thotë që gjyqtari të mos përmbushë në afat detyrimin për zbardhjen e vendimit përfundimtar brenda afatit ligjor të caktuar në nenin 308/2 të Kodit të Procedurës Civile.

8. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit me vendimin nr. 437, datë 10.09.2021 ka vendosur *Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. {...}*. Kundër vendimit është ushtruar e drejta e ankimit në Komisionin e Posaçëm të Apelimit (regjistruar çështja (JR) nr. 69/2021, datë 11.11.2021) dhe në kuptim të nenit F, pika 6, të Kushtetutës, magjistratja {...} ka status të pezulluar. Meqenëse ende nuk ka një vendim përfundimtar dhe të formës të prerë nga Komisioni i Posaçëm i Apelimit, magjistratja vazhdon të ruajë statusin e magjistratit për efekt të çdo procedimi disiplinor, në rastet e vërtetimit të një shkelje me pasojë përgjegjësinë disiplinore të magjistratit të parashikuar në nenet 102-104 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

9. Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në analizë të fakteve të konstatuara ka krijuar bindjen se ka dyshime të arsyeshme të bazuara në provat e marra gjatë verifikimit të ankesës, se nga ana e magjistrates {...}, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, mund të ishte kryer shkelja disiplinore e parashikuar në nenin 102, pika 1, shkronjat “d” të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, i cili parashikon shprehimisht se: “1. *Shkelje disiplinore gjatë ushtrimit të funksionit janë, në veçanti, por pa u kufizuar në to, veprimet,*

mosveprimet ose sjelljet e magistratit, si më poshtë...[...](d) vonesa të përsëritura ose që sjellin pasoja të rënda apo zvarritje të pajustificuara të veprimeve dhe/ose akteve procedurale;[...]”.

10. Për sa më sipër, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, me Vendimin nr. 2292 prot., datë 14.07.2023 ka vendosur fillimin e hetimit disiplinor ndaj magistrates {...}, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për shkeljen disiplinore të parashikuar nga neni 102, pika 1, shkronja “d”, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

11. Nga hetimi disiplinor ka rezultuar se në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, sot Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, është regjistruar çështja civile me nr. 3372 Akti, datë regjistrimi 21.01.2020, *me palë ndërgjyqëse, paditëse: {...} dhe të paditur Qani Lami; me objekt: Detyrimin e palës së paditur që të ndryshojë duke shtuar masën e pensionit ushqimor nga 16,000 lekë në 30,000 lekë për fëmijën e mitur G.L., ...etj.* Kjo çështje është gjykuar nga ana e gjyqtarës {...}, e cila në përfundim të gjykimit me vendimin nr. 2551, dt.22.04.2021, ka vendosur: “... *Pranimin e kërkesëpadisë.... Lënien e fëmijës ****, i dtl.10.05.2017, për rritje dhe edukim paditëses {...}.... *I padituri *****, të paguajë detyrimin ushqimor për fëmijën ****, në shumën 21.000 (njëzet e një mijë) lek në muaj. Ky detyrim fillon nga dita e ngritjes së padisë datë 20.06.2020. I padituri *** ka të drejtën e takimit me fëmijën *** çdo të shtunë të muajit nga ora 10.00 deri në orën 14.00, si dhe ta mbajën 15 ditë në pushimet verore... Vënien në ekzekutim të përkohshëm të këtij vendimi derisa të marrë formë të prerë në lidhje me detyrimin ushqimor për fëmijën ***....*”.

12. Referuar fletës së librit të dorëzimit të dosjeve në Kryesekretari rezulton se dosja gjyqësore së bashku me vendimin e arsyetuar është dorëzuar me datë 14.10.2021, për një afat kohor prej 5 muaj e 22 ditë nga shpallja e vendimit.

12.1 Paditësja {...}, ka ushtruar të drejtën e ankimit ndaj vendimit nr. 2551, datë 22.04.2021, i cili është regjistruar në Gjykatën e Apelit Tiranë (aktualisht Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm), me nr. 7329 (23000-02856-30-2021) regj.,them., datë regjistrimi 11.11.2021.

12.2 Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, me vendimin nr. 616, datë 18.07.2023, ka vendosur: Lënien në fuqi të vendimit nr. 2551, datë 22.04.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke ndryshuar vetëm disponimin në lidhje me masën e detyrimit ushqimor për fëmijën G.L., si: detyrimin e të paditurit Q.L. të paguajë detyrimin ushqimor për fëmijën G.L. në shumën 25,000 (njëzetë e pesë mijë lekë) në muaj.

12.3 Referuar të dhënave të marra nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, ka rezultuar se për periudhën e kërkuar 01.01.2021 – 31.12.2021,

numri i çështjeve gjyqësore të regjistruara pranë kësaj gjykate për të gjithë gjyqtarët është 30252 çështje të reja dhe 10008 çështje të mbartura.

12.4 Ndërsa, gjyqtarja {...} për periudhën 01.01.2021-10.09.2021 (datë e shkarkimit nga detyra nga KPK) ka pasur për shqyrtim 440 (katërqind e dyzet) çështje, nga të cilat 238 të mbartura nga viti 2020, 144 çështje të shortuara të reja dhe 58 çështje të ardhura gjatë periudhës së gadishmërisë. Ndërsa, ka përfunduar me vendim 182 (njëqind e tetëdhjetë e dy) çështje.

12.5. Për periudhën 01.01.2021 deri me datë 21.04.2021 gjyqtarja {...} ka shpallur 35 vendime gjyqësore, nga të cilat 18 vendime me objekt zgjidhje martesë dhe 17 vendime të tjera me objekt lëshim urdhra të menjëhershëm mbrojtje dhe urdhra mbrojtje apo për çështje të tjera familjare, vendime për të cilat lidhur me datën e dorëzimit të tyre në sekretari ka rezultuar Çështje civile familjare me objekt zgjidhje martesë (18 vendime), Çështje civile familjare, të tjera (17 vendime).

13. Gjithashtu, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, nga të dhënat e marra ka konstatuar se për periudhën 22.04.2021 (data e shpalljes së vendimit nr. 2551), deri më 14.10.2021 (data e dorëzimit të arsyetuar të këtij vendimi), gjyqtarja {...} ka shpallur dhe dorëzuar 140 vendime gjyqësore, nga të cilat: i) 74 vendime me objekt zgjidhje martesë; ii) 46 vendime me objekt lëshim urdhra të menjëhershëm mbrojtje dhe urdhra mbrojtje; iii) 3 vendime me objekt pension ushqimor; iv) 7 vendime me objekt lëshim autorizimi; v) 3 vendime me objekt njohje/çnjohje atëse; vi) 7 vendime për padi të tjera familjare.

13.1 Afati i arsytimit për 140 vendime të shpallura nga gjyqtarja {...}, në periudhën 22.04.2021-14.10.2021, sipas natyrës së çështjeve të gjykuara, rezulton të jetë: Çështje civile familjare me objekt zgjidhje martesë (74 vendime); Çështje civile familjare me objekt “urdhra mbrojtje” dhe “lëshim urdhra të menjëhershëm mbrojtje” (46 vendime); Çështje civile familjare me objekt pension ushqimor (3 vendime); Çështje civile familjare me objekt lëshim autorizimi (7 vendime); Çështje civile familjare me objekt çnjohje dhe njohje atësie (3 vendime); Çështje civile familjare të tjera (7 vendime).

14. Inspektori i Lartë i Drejtësisë në ushtrimin e veprimtarisë së tij, ndër të tjera udhëhiqet edhe nga parimi i ligjshmërisë në kuptimin që ka detyrimin të hetojë nëse ka shkaqe të mjaftueshme për të besuar se ka ndodhur në shkelje disiplinore. Në të njëjtën kohë, gjatë procesit hetimor duhet të analizohen një sërë çështjesh të cilët kanë të bëjnë me: (i) identifikimin e elementeve faktikë dhe juridikë të cilat provojnë, ekzistencën e shkeljes disiplinore, si dhe nuk diktojnë mbylljen e hetimit disiplinor; (ii) identifikimin e elementeve faktikë dhe juridikë mbi përgjegjësinë disiplinore të magjistratit subjekt hetimi disiplinor; (iii) si dhe identifikimin e elementeve faktikë dhe juridikë që justifikojnë fillimin e procedimit disiplinor.

15. Nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në analizë të identifikimit të elementeve faktikë dhe juridikë të cilat provojnë, ekzistencën e shkeljes disiplinore, si dhe nuk diktojnë mbylljen e hetimit disiplinor, nga provat e administruara në kuadër të këtij procesi hetimor, rezulton se në rastin konkret për sa i përket shkeljes disiplinore të parashikuar nga neni 102, pika 1, shkronja “d” të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nuk ekziston asnjë rrethanë faktike apo element juridik, i cili dikton mbylljen e këtij hetimi disiplinor, në mbështetje të parashikimeve të nenit 117, nenit 120, pika 1, shkronja “b”, “ç”, “d”, “dh”, nenit 134, pika 1, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

16. Për sa i përket ekzistencës së shkeljes që ka ndodhur brenda afatit të parashkrimit për hetimin disiplinor referuar nenit 117, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, rezulton se shkelja e pretenduar ka ndodhur në periudhën 22.04.2021 - 14.10.2021, brenda afatit 5 vjeçar të parashkrimit të shkeljes disiplinore dhe si pasojë çështja nuk rezulton të jetë parashkruar.

16.1 Magjistratja subjekt hetimi disiplinor znj. {...}, ushtronte detyrën e gjyqtares në kohën kur shkelja e pretenduar ka ndodhur. Aktualisht gëzon statusin e magjistrates si e pezulluar, pasi është shkarkuar nga detyra *me vendimin nr. 437, datë 10.09.2021 të KPK-së. Kundër vendimit është ushtruar e drejta e ankimit në Komisionin e Posaçëm të Apelit (regjistruar çështja (JR) nr. 69/2021, datë 11.11.2021) dhe në kuptim të nenit F, pika 6, të Kushtetutës, kjo magjistrate ka status të pezulluar*. Meqenëse ende nuk ka një vendim përfundimtar dhe të formës të prerë nga KPA, kjo magjistrate vazhdon të ruajë statusin e magjistratit për efekt të çdo procedimi disiplinor, në rastet e vërtetimit të një shkelje me pasojë përgjegjësinë disiplinore të magjistratit të parashikuar në nenet 102-104 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe për rrjedhojë nuk ekzistojnë elementë për mbylljen e hetimit disiplinor për shkak statusi referuar nenit 134 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

17. Për sa i përket identifikimit të elementeve faktikë dhe juridikë të cilat provojnë, ekzistencën e shkeljes disiplinore nga ligji në kohën e kryerjes së saj, si dhe në kohën e konstatimit të saj, nëse provohet kryerja e veprimeve/mosveprimeve nga ana e magjistratit subjekt hetimi disiplinor ato përbëjnë shkelje disiplinore të parashikuara nga neni 102, pika 1, shkronja “d” e Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

17.1 Sipas Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, nga të dhënat e administruara në dosjen e hetimit disiplinor, nuk rezulton që shkelja objekt hetimi disiplinor të jetë hetuar më parë apo të jetë përfunduar me një vendim respektiv, për rrjedhojë nuk ekzistojnë elementë për

mbylljen e hetimit disiplinor për këtë shkak, referuar nenit 134 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

18. Në mbështetje të parashikimeve të nenit 3, 4, 101, 102, pika 1 shkronja “d”, 105, 115, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, me qëllim identifikimin e elementeve juridikë dhe faktikë mbi përgjegjësinë disiplinore të magjistrates subjekt hetimi disiplinor, paraprakisht ka vlerësuar se gjatë procesit hetimor duhet të analizohen këto çështje: (i) veprimi apo mosveprimi i magjistratit subjekt hetimi disiplinor përbën shkelje disiplinore apo veprimi/mosveprimi lidhet me veprimtarinë e saj profesionale; (ii) kriteret për caktimin e rëndësisë së shkeljes disiplinore; (iii) llojin e masës disiplinore.

18.1 Mbi shkeljen disiplinore të kryer nga magjistratja, vlen të theksohet se në mbështetje të nenit 101, pika 1, shkronja “a” të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, magjistrati kryen shkelje disiplinore, me dashje ose për shkak të pakujdesisë, kur: (a) kryen veprime ose mosveprime, të cilat përbëjnë mospërmbushje të detyrës, sjellje joprofesionale ose joetike gjatë ushtrimit të funksionit ose jashtë tij, të cilat diskreditojnë pozitën dhe figurën e magjistratit, ose dëmtojnë besimin e publikut në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë.

18.2 Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në analizë të çështjes se nëse nga ana e magjistrates, subjekt hetimi disiplinor janë ndërmarrë veprime/mosveprime të cilat përbëjnë shkelje disiplinore apo veprimi/mosveprimi lidhet me veprimtarinë e saj profesionale, thekson se në mbështetje të nenit 101, pika 2, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, kur përcaktohet nëse veprimi apo mosveprimi i magjistratit konsiderohet shkelje disiplinore, ose është e lidhur vetëm me veprimtarinë profesionale, merren parasysh një sërë faktorësh si: (a) shkalla e pakujdesisë (fajësisë); (b) shpeshësia e kryerjes së veprimit ose mosveprimit apo sjelljes; (c) përvoja dhe pozicioni i magjistratit në sistem; (ç) dëmtimi, mundësia e shkaktimit të dëmtimit ose shkalla e pasojave që kanë ardhur ose mund të vijnë nga veprimi apo mosveprimi; si dhe (d) çdo situatë që është jashtë kontrollit të magjistratit dhe që mund të lidhet me mosfunksionimin e sistemit gjyqësor ose të prokurorisë.

18.3 Nga provat e administruara gjatë hetimit disiplinor rezulton se veprimi apo mosveprimi i magjistrates {...} nuk është i natyrës që lidhet vetëm me vlerësimin profesional, por në rastin konkret konstatohet ekzistenca e elementëve të shkeljeve disiplinore, sipas parashikimeve të nenit 102, pika 1, shkronja “d” të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

19. Nga veprimet hetimore të kryera dhe provat e mbledhura në funksion të hetimit disiplinor, rezulton se gjyqtarja {...} në përfundim të gjykimit të çështjes objekt hetimi disiplinor ka disponuar me vendimin nr. 2551, datë 22.04.2021, të Gjykatës së Rrethit

Gjyqësor Tiranë për: *Pranimin e kërkesëpadisë. Lënien e fëmijës ****, i dtl.10.05.2017, për rritje dhe edukim paditëses {...}. I padituri ****, të paguajë detyrimin ushqimor për fëmijën ***, në shumën 21.000 (njëzet e një mijë) lek në muaj. Ky detyrim fillon nga dita e ngritjes së padisë datë 20.06.2020. I padituri *** ka të drejtën e takimit me fëmijën *** çdo të shtunë të muajit nga ora 10.00 deri në orën 14.00, si dhe ta mbajën 15 ditë në pushimet verore. Vënien në ekzekutim të përkohshëm të këtij vendimi derisa të marrë formë të prerë në lidhje me detyrimin ushqimor për fëmijën ***. Nga fleta e rregjistrimit të dorëzimit të vendimit të arsyetuar në kryesekretari, rezulton se vendimi është arsyetuar dhe dosja është dorëzuar në kryesekretari në datë 14.10.2021 për një afat 5 muaj dhe 22 ditë.

20. Dorëzimi i këtij vendimi në këtë afat tejet të gjatë, rezulton të jetë në kapërcim të afatit 20 ditor të parashikuar në nenin 308, paragrafi i dytë i Kodit të Procedurës Civile, afat i cili është tejkaluar, me një vonesë prej 172 ditë nga shpallja e vendimit përfundimtar, si dhe të afatit 15 ditor të parashikuar nga neni 443, paragrafi i parë i K.Pr.Civile për ushtrimin e të drejtës së ankimit nga palët në proces.

21. Nga provat e marra gjatë hetimit rezulton se mosveprimi i gjyqtarës {...} nëpërmjet mosarsyetimit të vendimit nr. 2551, datë 22.04.2021, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë në afatin e parashikuar dhe duke vepruar me vonesë tej çdo afati të arsyeshëm dhe objektiv ka sjellë si pasojë zvarritjen e pajustificuar të procesit gjyqësor, si dhe kryerjen e veprimeve të tjera procedurale në kuadër të këtij procesi.

22. Gjatë hetimit disiplinor magjistratja {...}, pasi është njoftuar dhe ka marrë dijeni për fillimin e hetimit disiplinor ndaj saj, si dhe me njohjen e të drejtave përgjatë hetimit, ka depozituar parashitëse me shkrim si dhe ka bashkëlidhur dhe akte si, kopje të raporteve mjekësore, shkresa të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë lidhur me ngarkesën në punë dhe shpalljen e vendimeve gjyqësore nga data 01.01.2021-10.09.2021 të gjyqtarës {...}, gjithashtu dhe kopje të dosjes gjyqësore të vendimit objekt hetimi.

22.1 Ndër të tjera magjistratja {...} ka shpjeguar se: “Në lidhje me dorëzimin jashtë afatit ligjor të dosjes në fjalë, si dhe të dosjeve të tjera të cituara në vendimin Tuaj, sqaroj se në muajin Shkurt dhe në muajin Mars të vitit 2021 gjendja ime shëndetësore ka qenë shumë e rënduar si pasojë e infektimit me virusin Covid-19, gjendje e cila ka vijuar dhe më pas pasi jam kthyer në punë me datë 23.03.2021 dhe për një periudhë disa mujore. Ndërkohë gjatë muajit Gusht kam qenë gjyqtare e gatshme me urdhrat e menjëhershëm të mbrojtjes. Gjithashtu ndikim në vonesat lidhur me dorëzimin me vonesë të vendimeve gjyqësore të arsyetuara ka patur dhe fakti se gjatë kësaj periudhe kam qenë në proces vetingu, për të cilën për efekt detyrimi ligjor sigurimi i dokumentacionit të nevojshëm dhe përmbushja në tërësi e kërkesave të Komisionit kërkonte kohë të konsiderueshme, pasi për këtë më është dashur të shkoj personalisht nëpër institucione”.

22.2 Në vlerësim të pretendimeve të parashtruara, në raport dhe me aktet e paraqitura nga vetë subjekti i hetimit disiplinor si dhe aktet e administruara gjatë hetimit ka rezultuar se, për periudhën 01.01.2021 – 31.03.2021 gjyqtare {...} ka shpallur 16 vendime gjyqësore në intervale të datave 15.01.2021 deri me datë 04.02.2021.

22.3 Referuar datave të dorëzimit të tyre të arsyetura në sekretari rezulton se, asnjë nga vendimet nuk është dorëzuar brenda afatit ligjor, ndërsa janë dorëzuar në një afat prej më shumë se: i) 2 muaj, 3 vendime (vendimet: - nr. 123, datë 15.01.2021 për një afat 2 muaj e 11 ditë; - nr. 303, datë 25.01.2021 për një afat 2 muaj e 14 ditë; - nr. 486, datë 01.02.2021 për një afat 2 muaj e 28 ditë); ii) 3 muaj, 10 vendime; iii) 9 muaj, 1 vendim; iv) 11 muaj, 1 vendim; v) 1 vendim, 1 vit e dy muaj. Nisur nga kjo analizë duke zbritur periudhën e mungesës në punë të gjyqtarës {...} si pasojë e sëmundjes (06.02.2021 – 06.03.2021) apo për shkak të lejes vjetore (08.03.2021-23.03.2021) nuk rezulton që asnjë vendim të jetë dorëzuar brenda afatit ligjor.

22.4 Ndërsa, brenda periudhës 01.04.2021-10.09.2021 (*data e shkarkimit nga detyra me vendim të KPK*), gjyqtarja {...} nuk është paraqitur në punë për arsye të justifikuara gjithsej 23 ditë, konkretisht në datat 02.06.2021-05.06.2021 dhe 10.06.2021-12.06.2021 për paaftësi të përkohshme për shkak sëmundje si dhe në datat 02.08.2021-13.08.2021 dhe 24.08.2021-31.08.2021 për shkak të qënies me leje vjetore. Periudha të cilat nuk përbëjnë shkaqe objektive që mund të kenë ndikuar për dorëzimin me vonesë të arsyetimit të vendimit gjyqësor nr. 2551, datë 22.04.2021, në një afat prej 5 muaj e 22 ditë.

23. Inspektori i Lartë i Drejtësisë thekson se nga hetimi i zhvilluar nuk u konstatuan as kryesisht shkaqe apo rrethana të cilat të justifikojnë vonesën në arsyetimin e vendimit gjyqësor nr. 2551, datë 22.04.2021, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë nga ana e magjistrates {...}, duke konkluduar që zvarritja e arsyetimit të këtij vendimi të jetë e pajustificuar. Gjyqtarja {...} pavarësisht mungesave në detyrë cituara më lart, referuar listprezencës së përcjellë nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nga kohëzgjatja e tyre vlerësohet se ato janë të tilla që nuk kanë ndikuar në mosarsyetimin e vendimit gjyqësor në kohë.

24. Për rrjedhojë nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, vlerësohet se nga ana e magjistrates {...} është kryer shkelja disiplinore e parashikuar nga neni 102, pika 1, shkronja “d” e Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

25. Nga ana tjetër, sipas Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, nga aktet e marra gjatë hetimit disiplinor rezulton se pasi vendimi është dorëzuar së bashku me dosjen në kryesekretari në datën 14.10.2021, kjo e fundit menjëherë i ka komunikuar vendimin palëve ndërgjyqëse, ku pala paditëse {...} pasi ka marrë dijeni në datën 15.10.2021 ka paraqitur ankim në datën 29.10.2021. Pas dërgimit të dosjes në Gjykatën e Apelit çështja është rregjistruar në datën 11.11.2021 dhe kjo gjykatë pas shqyrtimit të çështjes me vendimin nr. 616, datë 18.07.2023,

ka lënë në fuqi vendimin nr. 2551, datë 22.04.2021, të Gjykatës së Shkallës së Parë, duke ndryshuar vetëm disponimin në lidhje me masën e detyrimit ushqimor për fëmijën G. L., nga 21.000 (njëzet e një mijë), në 25.000 (njëzet e pesë mijë).

26. Pra, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka konkluduar se si pasojë e mosveprimit në kohë dhe vonesës së pajustificuar tej çdo afati të arsyeshëm dhe objektiv të arsyetimit të vendimit nr. 2551, datë 22.04.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nga ana e magjistrates {...}, ka sjellë si pasojë zvarritjen e pajustificuar të procesit gjyqësor, zvarritje në kryerjen e veprimeve të tjera procedurale në kuadër të këtij procesi, si depozitimi i ankimit nga ana e palës paditëse {...} dhe për rrjedhojë edhe vonesa në shqyrtimin e ankimit të saj nga një gjykatë më e lartë sikundërse është Gjykata e Apelit Tiranë. Vendim i cili është marrë nga kjo e fundit me datë 18.07.2023, kjo jo vetëm për shkak të ngarkesës së kësaj të fundit, por edhe si pasojë e drejtpërdrejtë e vonesës prej 5 muaj dhe 22 ditë në arsyetimin e vendimit përfundimtar nga ana e gjyqtarës {...}. Vonesë e cila ka ndikuar në mos garantimin e të ardhurave më të larta me qëllim parësor mirëqënien dhe edukimin e fëmijës së mitur.

27. Duke patur në konsideratë natyrën e veprimeve apo mosveprimeve të cilat përbëjnë shkelje disiplinore objekt hetimi disiplinor, Inspektori i Lartë i Drejtësisë vlerëson se në rastin konkret duhet të mbahet në konsideratë edhe qëndrimi i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin nr. 5, datë 12.12.2013¹ i cili argumenton kushtet dhe rrethanat në të cilat shkeljet e kësaj natyre, ngarkojnë me përgjegjësi disiplinore gjyqtarin kur: (i) këto vonesa janë të vazhdueshme, të përsëritura dhe të pajustificuara; (ii) këto vonesa kanë sjellë ose mund të sjellin pasoja për të drejtat kushtetuese të palëve në gjykim apo për dhënien e drejtësisë (sidomos në rastet kur ndaj vendimit që pritet të dorëzohet i arsyetuar është ushtruar ankim); (iii) këto vonesa nuk justifikohen nga ngarkesa e punës që ka gjyqtari apo nga kompleksiteti i çështjeve që ai ka në shqyrtim; (iv) këto vonesa nuk justifikohen nga shkaqe të arsyeshme personale, shëndetësore, familjare, të cilat janë të lidhura direkt me gjyqtarin; (v) këto vonesa janë jashtë çdo afati të arsyeshëm logjik dhe objektiv; (vi) këto vonesa kanë cenuar imazhin e drejtësisë dhe kanë ulur besimin e publikut të drejtësia.

27.1 Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë se edhe duke marrë në konsideratë shkaqet e mësipërme objektive (në rast se ato ekzistojnë), vendimet gjyqësore duhet të dorëzohen brenda një afati të arsyeshëm. Në çdo rast duhet të gjenden zgjidhje ligjore brenda institucionit në mënyrë që dorëzimi i tyre të mos marrë më shumë kohë se sa ka marrë vetë procesi gjyqësor, apo ato të mbahen pafundësisht të bllokuara dhe të pa dorëzuara, sepse vonesa të tilla ndikojnë dhe kanë efekt të drejtpërdrejtë tek palët në proces pasi u cenohen këtyre të fundit të drejtat e tyre kushtetuese dhe përfundimisht procesi gjyqësor rezulton në një proces jo efektiv.

¹ Çështja me palë: paditës N.T, kundër të paditurit K.L.D-së, me objekt padi: kundërshtim vendimi të KLD-së për shkarkimin e paditësit nga detyra e gjyqtarit.

28. Sa sipër, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, me vendimin nr. 2292/27 prot., datë 12.01.2024, ka vendosur :

- a) *Përfundimin e hetimit disiplinor ndaj magistrates {...}, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për shkelje disiplinore të parashikuar nga neni 102, pika 1 shkronja “d”, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.*
- b) *Fillimin e procedimit disiplinor ndaj magistrates {...}, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për shkelje disiplinore të parashikuar nga neni 102, pika 1 shkronja “d”, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.*
- c) *Propozimin e masës disiplinore “Shkarkim nga detyra”, parashikuar nga neni 105, pika 1, shkronja “dh”, dhe neni 111 i Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.....*

II. PROCEDURA E ZHVILLUAR NË KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

29. Pas depozitimit të kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magistrates {...}, me vendimin nr. 29, datë 24.01.2024, Këshilli ka vendosur të caktojë si relatore të çështjes, znj. Gentiana Muçaj, në cilësinë e anëtarit të Komisionit Disiplinor. Vendimi për caktimin e relatorit të çështjes i është njoftuar palëve të procedimit disiplinor përkatësisht Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe magistratëve, brenda afatit 5 ditor të parashikuar në nenin 141 të Ligjit për Statusin.

30. Me vendimin nr. 39, datë 31.01.2024, mbi propozimin e relatorit të çështjes, Këshilli ka vendosur kalimin e çështjes në seancë dëgjimore, duke caktuar datën 15 shkurt 2024, ora 11.00, si datë të zhvillimit të seancës dëgjimore, për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magistrates {...}, duke njoftuar rregullisht palët në zbatim të parashikimeve të nenit 138 të Ligjit për Statusin.

30.1 Bashkë me njoftimin për caktimin e seancës dëgjimore, magistratit i janë njoftuar dhe të drejtat e tij gjatë procedimit disiplinor, si dhe i është caktuar një afat deri në datë 13.02.2024 për të paraqitur një parashtesë me shkrim, sipas përcaktimeve të nenit 141, pika 2, gërma a) të ligjit.

31. Magistratja znj. {...} ushtron funksionin e gjyqtares pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, aktualisht është me status i pezulluar, bazuar në vendimin nr. 437 datë 10.09.2021 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me të cilin ka vendosur : “1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. {...}, me detyrë

gjqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.....”. Nga verifikimi i faqes elektronike të Komisionit të Posaçëm të Apelimit rezulton se ankimi dhe vendimi i KPK-së janë në proces shqyrtimi deri në vendimmarrje të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit regjistruar çështja (JR) nr. 69/2021, datë 11.11.2021).

32. Pas shqyrtimit të kësaj rrethane faktike, në seancën dëgjimore të datës 29.02.2024, relatorja e çështjes i parashtrroi Këshillit të Lartë Gjyqësor, propozimin e saj për pezullimin e procedimit disiplinor të filluar ndaj magjistrates {...}, deri në marrjen formë të prerë të vendimeve të dhëna nga organi kompetent i rivlerësimit Komisioni i Pavarur i Kualifikimit.

32.1 Inspektori i Lartë i Drejtësisë, përfaqësuesi i tij, parashtrroi pretendimet duke kërkuar pranimin e kërkesës, ndërsa magjistrata {...} kërkoi rrëzimin e kërkesës së paraqitur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë pasi nuk justifikonte as qëllimin e parashikuar në ligj.

III. LIGJI I ZBATUESHËM

33. Në nenin 97, pika 3 të ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, parashikohet se: “3. *Këshilli i Lartë Gjyqësor zbaton Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë në çdo rast ose situatë tjetër që nuk parashikohet shprehimisht nga ky ligj.*”

34. Në aspektin e pezullimit të një procedure administrative individuale, Kodi i Procedurave Administrative, në nenin 66 të tij, jep kuptimin e çështjes paraprake si parakusht për zgjidhjen e procedurës së filluar nga një organ publik. Sipas këtij neni: “1. *Nëse organi publik që zhvillon procedurën përballet me një çështje, zgjidhja e së cilës është parakusht për zgjidhjen e procedurës dhe që përbën një çështje ligjore të pavarur, për zgjidhjen e së cilës është kompetent një gjykatë ose organ tjetër (“çështja paraprake”), organi publik që zhvillon procedurën administrative pezullon procedurën deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë për çështjen paraprake dhe njofton palën në lidhje me këtë. ...*”.

35. Edhe në Ligjin për Statusin trajtohet çështja e pezullimit të procedurës administrative, vetëm në aspektin e ndërvarësisë së procedimit disiplinor nga rezultatet e procedurave të filluara nga organe të tjera, pra në rastet e zhvillimit të një hetim penal ose të një procesi gjyqësor penal, administrativ, ose civil, ku është palë dhe magjistrati nën hetim ose procedim disiplinor dhe shkelja disiplinore e dyshuar ose e atribuar atij lidhet me të njëjtat fakte. Konkretisht, në nenin 145 të Ligjit, titulluar “*Pezullimi i procedimit disiplinor*”, përcaktohet se: “*Parashikimet ligjore gjatë procedimit disiplinor të nenit 126, të këtij ligji, do të aplikohen për aq sa gjejnë zbatim*”. Nga ana tjetër, në nenin 126, të këtij ligji, titulluar “*Pezullimi i hetimeve*”², parashikohet se: “1. *Inspektori i Lartë i Drejtësisë vendos pezullimin e hetimit disiplinor kur është duke u zhvilluar hetim penal ose një proces gjyqësor*

² Ndryshuar me Ligjin nr. 48/2019

penal, administrativ ose civil: a) në të cilat, njëra nga palët është magjistrati; b) shkelja e dyshuar lidhet me të njëjtat fakte, për të cilat do të merret vendimi. 2. Hetimi pezullohet deri në dhënien e vendimit të formës së prerë të institucionit kompetent. 6. Vendimi për pezullimin e hetimit nuk ankimohet.”

36. Neni 179/b, pika 7, e Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë³, ka parashikuar se: “7. Moskalimi me sukses i procesit të rivlerësimit përbën shkak për mbarimin e menjëhershëm të ushtrimit të detyrës, krahas shkaqeve të parashikuara në Kushtetutë. ...”

37. Më tej, neni 164 i Ligjit për Statusin, në dispozitat e tij kalimtare, përcakton se: “1. Gjyqtarët dhe prokurorët në detyrë gëzojnë statusin e magjistratit të parashikuar në këtë ligj vetëm nëse: ...b) kalojnë me sukses procesin e rivlerësimit, në përputhje me ligjin “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.”

IV. VLERËSIMI I KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

38. Referuar të dhënave faktike të rastit rezulton se magjistratja znj. {...}, në të njëjtën kohë, është nën dy procedime disiplinore, ku ai i filluar më herët (procesi i rivlerësimit kalimtar sipas përcaktimeve të nenit 179/b të Kushtetutës dhe të Ligjit nr. 84/2016) tashmë ka përfunduar dhe organi kompetent disiplinor ka marrë masën disiplinore “Shkarkim nga detyra”, vendim ky që mund të jetë objekt i kontrollit nga organi më i lartë i rivlerësimit, mbi ankimin e magjistrates. Ndërkohë, procedimi i dytë disiplinor ndaj magjistrates (sipas përcaktimeve të Ligjit për Statusin) është aktualisht për shqyrtim përpara organit të përhershëm disiplinor të gjyqtarëve, pra Këshillit të Lartë Gjyqësor.

39. Sipas parashikimeve ligjore në fuqi, vendimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për “Shkarkimin nga detyra” të magjistratëve, përbëjnë masë disiplinore në kuptim të legjislacionit në fuqi, ç’ka përcaktohet shprehimisht në nenin 58, pika 1 (Masat disiplinore)⁴, sikundër edhe në nenin 61 (Shkarkimi nga detyra)⁵, të Ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Vendimi i këtij organi kushtetues për dhënien e masës disiplinore “Shkarkim nga detyra”, është një vendim, pasojat juridike e të cilit fillojnë menjëherë, duke përbërë shkak për ndërprerjen e menjëhershme të ushtrimit të detyrës nga gjyqtari ose prokurori subjekt rivlerësimi, ndaj të cilit ai është marrë⁶. Nga ana tjetër, Ligji për Statusin, kalimin me sukses të procesit të

³ Shtuar me Ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016

⁴ “1. Në përfundim të procesit, Komisioni mund të vendosë për subjektet e rivlerësimit: ...; c) shkarkimin nga detyra....”.

⁵ “Shkarkimi nga detyra i subjektit të rivlerësimit jepet si masë disiplinore në këto raste: ...”.

⁶ Neni 62, i Ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, përcakton se: “1. Subjekti i rivlerësimit, i cili ka ushtruar të drejtën e ankimit ndaj vendimit të Komisionit për masën disiplinore për shkarkimin nga detyra, pezullohet ex lege nga detyra e tij në pritje të vendimit të Kolegjit të Apelimeve. Gjatë periudhës së pezullimit atij i njihet e drejta e pagës në masën 75 për qind të saj, në përputhje me nenin F, pika 5, të Aneksit të Kushtetutës. 2. Në këtë rast, subjekti i rivlerësimit nuk ka të drejtë të shqyrtojë dhe të gjykojë çështje. ...”.

rivlerësimit, në përputhje me Ligjin “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, e konsideron si parakusht për vijimin e gëzimit nga gjyqtarët në detyrë, të statusit të magjistratit të parashikuar në këtë ligj.

40. Në rastin konkret, ky proces, i natyrës disiplinore, për magjistratin subjekt të këtij procedimi disiplinor, aktualisht ka përfunduar përpara Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, ku me vendimin përkatës, organi disiplinor kompetent për kontrollin e ligjshmërisë së pasurisë, të pastërtisë së figurës dhe pasjes së aftësive minimale profesionale për periudhën e rivlerësimit sipas pikës 5, neni 179/b, të Kushtetutës dhe Ligjit nr. 84/2016, ka vendosur marrjen e masës disiplinore “Shkarkim nga detyra”, masë e cila sipas ligjit krijon si efekt të menjëhershëm pezullimin nga detyra të magjistratit deri në përfundim të shqyrtimit të çështjes së rivlerësimit nga organi kontrollues, Kolegji i Posaçëm i Apelit, si Dhoma e Dytë e Gjykatës Kushtetuese, në rast të ankimit të vendimit të masës disiplinore.

41. Fakti që masa disiplinore “Shkarkim nga detyra” nuk është vendosur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor sipas përcaktimeve të Ligjit për Statusin, nuk mund të çojë në mos ekzistencën e kësaj mase disiplinore dhe as në anashkalimin e saj. Me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, si edhe të rikthehet besimi i publikut tek institucionet e këtij sistemi, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, me ndryshimet e vitit 2016, parashikoi ngritjen e sistemit të rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, një proces ky i jashtëzakonshëm dhe tranzitor, që kryhet nga organet e pavarura kushtetuese dhe që ka për qëllim kontrollin e ligjshmërisë së pasurisë, të pastërtisë së figurës dhe të pasjes së aftësive minimale profesionale. Në kuadër të këtij procesi ligjor, Kushtetuta dhe ligji i dalë në zbatim të saj (Ligji 84/2016), kanë konsideruar që, në raport me objektin e rivlerësimit kalimtar, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit vepron si organ disiplinor ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve.

42. Nisur nga kjo, vendimmarrja e këtij organi disiplinor, e dhënë brenda kompetencave të tij, nuk mund të anashkalohet dhe të mos merret në konsideratë, përfshirë edhe nga Këshilli i Lartë Gjyqësor. Në vendimin nr. 2, datë 18.01.2017, Gjykata Kushtetuese është shprehur se: “...22. *I gjithë procesi i rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, si pjesë e paketës së reformës në drejtësi, edhe pse është një masë e jashtëzakonshme dhe me karakter të përkohshëm, është ngritur nga kushtetutëbërësi në rang kushtetues, duke parashikuar institucionet që do të kryejnë këtë proces, kompetencat e tyre, si edhe mënyrën e zgjedhjes së anëtarëve dhe garancitë që ata gëzojnë. Qëllimi i përcaktimit të kompetencave të këtyre organeve në mënyrë të drejtpërdrejtë në Kushtetutë do të thotë se asnjë institucion nuk mund të marrë këto kompetenca apo t'i anashkalojë ato*”. Nga ana tjetër, në hipotezën që ndaj vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, nuk ushtrohet ankim nga magjistrati apo lihet në fuqi nga organi më i lartë kontrollues, kjo masë disiplinore sjell si pasojë mbarimin e statusit të magjistratit për znj. {...}.

43. Ligjërisht, procesi i rivlerësimit kalimtar dhe procedimi disiplinor sipas Ligjit për Statusin, janë dy procese të pavarura nga njëri tjetri, që zhvillohen nga organe të ndryshme, të pavarura dhe sipas procedurave jo të njëjta, rrethana këto që, pavarësisht faktit që ato zhvillohen ndaj të njëjtit magjistrat, bëjnë të pamundur bashkimin e tyre në një procedim të vetëm. Ndërkohë këto procese kanë ndikim ndaj njëri tjetrit, duke përcaktuar vijueshmërinë e tyre. Kështu, procesi i rivlerësimit, që është një proces i detyrueshëm për të gjithë gjyqtarët në detyrë (në momentin e miratimit të ndryshimeve kushtetuese të vitit 2016), përcakton vijimin e gëzimit nga ata të statusit të magjistratit sipas Ligjit për Statusin. Nga ana tjetër, moskalimi me sukses i procesit të rivlerësimit passjell mbarimin e menjëhershëm të statusit të magjistratit, rrethanë kjo që përbën shkak për mbylljen e procedimit disiplinor sipas Ligjit për Statusin, referuar nenit 139, pika 1, shkronja “c”⁷ në lidhje me nenin 134, pika 1, shkronja “ç”⁸, nenin 64, pika 1, shkronja “ç”⁹ dhe nenin 164, të tij.

44. Vlen të theksohet se masa disiplinore “*Shkarkim nga detyra*”, sipas përcaktimeve të ligjit për rivlerësimin kalimtar, pra mbi bazën e një ligji me natyrë kalimtare, nuk mund sanksionohet nga ligjvënësi si një mënyrë e mbarimit të statusit, në dispozitat e nenit 64 të Ligjit për Statusin, por vetëm në dispozitat kalimtare të tij. Konkretisht, është neni 164 të këtij ligji, i cili vendos një urë lidhëse midis dy ligjeve, duke zgjeruar interpretimin e shkronjës “ç”, të pikës 1, të nenit 64, dhe duke sanksionuar se statusi i magjistratit mbaron edhe në rastet kur ai shkarkohet nga funksioni për përgjegjësi disiplinore sipas ligjit, “*Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*”. Ndërkohë, e njëjta situatë ndodh edhe në rastin kur procedimi disiplinor sipas Ligjit për Statusin përfundon me dhënien e masës disiplinore “*Shkarkimin nga detyra*”, vendim ky që impakton vijimin e procesit të rivlerësimit kalimtar ndaj atij magjistrati, referuar për këtë jurisprudencës së organeve të rivlerësimit.

45. Ligji për Statusin ka rregulluar edhe pezullimin e procedimit disiplinor në nenin 145, dispozitë kjo që referon në nenin 126 të tij, që bën fjalë për pezullimin e hetimit disiplinor. Në rastin konkret, jemi para një procesi administrativ (procesi i rivlerësimit kalimtar) që zhvillohet ndaj magjistrates znj. {...}, objekti i të cilit është pikërisht verifikimi i kërkesave kushtetuese për vijimin e mbajtjes prej tyre të statusit të magjistratit. Duket sikur rasti në shqyrtim nuk është pikërisht ai për të cilin bën fjalë neni 126, pika 1, i Ligjit për Statusin, kjo sa i përket rrethanës sipas shkronjës “b”, për sa kohë shkelja e dyshuar disiplinore në rastin konkret nuk lidhet me faktet objekt të procesit të rivlerësimit kalimtar ndaj magjistratit. Por, pavarësisht kësaj, duhet thënë sërish se procesi i rivlerësimit kalimtar, si një masë e jashtëzakonshme dhe me karakter të përkohshëm, e ngritur nga kushtetutëbërësi

⁷ “1. Këshilli vendos mbylljen e procedimit disiplinor pa zhvilluar seancë dëgjimore nëse: ...; c) ka arsye të tjera për të mbyllur procedimin, në përputhje me parashikimet e nenit 134, pika 1, shkronjat “ç” dhe “d”; ...”.

⁸ “1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë mbyll hetimin, nëse provohet se pretendimet janë të pabazuara ose provat e mbledhura dhe rezultatet e hetimit të çojnë drejt përfundimit se: ...; ç) magjistratit i mbaron statusi, bazuar në kriteret e parashikuara, në shkronjat “b” deri në “ç”, të pikës 1, të nenit 64, të këtij ligji...”.

⁹ “1. Statusi i magjistratit mbaron në rastet kur: ...; ç) shkarkohet nga funksioni për përgjegjësi disiplinore, sipas parashikimeve të këtij ligji; ...”.

në rang kushtetues, nuk është një rrethanë pjesë e rregullimeve të përhershme ligjore në Ligjin për Statusin lidhur me përgjegjësinë disiplinore të magjistratëve, kjo në mënyrë të vetëkuptueshme për shkak të përkohshmërisë së zbatimit të tyre.

46. Nga ana tjetër, po ashtu, siç mund të konstatohet, dualiteti i mundshëm i procedimeve disiplinore ndaj magjistratëve për periudhën e përkohshme nuk ka gjetur trajtim, përmes ndonjë rregullimi specifik, as në dispozitat tranzitore të Ligjit për Statusin (përveç sa parashikohet në nenin 164 të tij). Ndërkohë, në kuptim dhe zbatim të këtij ligji, magjistrati nuk mund të jetë në të njëjtën kohë nën disa hetime ose procedime disiplinore të veçanta, kjo për shkak të ndikimit që ato kanë lidhur me sanksionin disiplinor sipas kriterëve të përcaktuara në nenin 115, të Ligjit për Statusin. Kështu, në rastin kur magjistrati është nën hetim disiplinor, ndërsa ngrihen dyshime të arsyeshme se ka ndodhur një shkelje tjetër disiplinore, atëherë objekti i hetimit disiplinor duhet të shtohet ose ndryshohet¹⁰ ose procedimet hetimore duhet të bashkohen kur ato iu referohen të njëjtave fakte¹¹. Po ashtu, edhe në rastin kur magjistrati është nën procedim disiplinor, ndërsa ngrihen dyshime të arsyeshme se mund të jetë kryer një shkelje tjetër disiplinore, atëherë procedimi disiplinor ndërpritet dhe çështja i kalon Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për kryerjen e hetimeve të mëtejshme dhe, në eventualitet, mund të shtohet ose ndryshohet objekti i procedimit disiplinor, si dhe, nëse është rasti i panevojshmërisë së hetimeve të mëtejshme, procedimi disiplinor vazhdon duke u shtuar ose ndryshuar objekti i tij¹². Dhe po ashtu, kur magjistrati gjendet nën disa procedime disiplinore që iu referohen të njëjtave fakte, procedimet bashkohen¹³.

¹⁰ Neni 125 i Ligjit për Statusin, titulluar “Shtimi ose ndryshimi i objektit të hetimit”, parashikon se: “1. Në rast se gjatë hetimit ngrihen dyshime të arsyeshme se ka ndodhur një shkelje tjetër, Inspektori i Lartë i Drejtësisë merr vendim për të shtuar ose ndryshuar objektin e hetimit, në zbatim të nenit 124 të këtij ligji. 2. Rregullat e parashikuara në pikat 2 deri në 4, të nenit 123, të këtij ligji, aplikohen për aq sa gjejnë zbatim”.

¹¹ Neni 128 i Ligjit për Statusin, titulluar “Bashkimi i procedimeve hetimore”, parashikon se: “Inspektori i Lartë i Drejtësisë bashkon procedimet, në rastet kur konstaton se ankesat ose hetimet e filluara u referohen të njëjtave fakte ose të njëjtit magjistrat”.

¹² Neni 136 i Ligjit për Statusin, titulluar “Dërgimi i çështjes Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, parashikon se: “1. Nëse gjatë procedimit disiplinor, Inspektori i Lartë i Drejtësisë vlerëson se ka dyshime të arsyeshme që mund të jetë kryer një shkelje tjetër, atëherë: a) kërkon të ndërpresë procedimin disiplinor, vendos për shtimin ose ndryshimin e objektit të hetimit, kryen hetimin e nevojshëm dhe paraqet raportin e hetimit të mëtejshëm brenda një muaji nga ndërprerja e procedimit; b) i kërkon Këshillit që të shtojë ose ndryshojë objektin e hetimit, nëse nuk është e nevojshme kryerja e hetimeve të mëtejshme, pasi të ketë marrë mendimin e palëve. 2. Këshilli mund të dërgojë çështjen te Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në rastet e parashikuara në nenin 144 të këtij ligji”; si dhe neni 144, i këtij ligji, titulluar “Ndryshimi ose shtimi i objektit të procedimit disiplinor”, parashikon se: “1. Kur Këshilli çmon se çështja nuk mund të zgjidhet në mënyrë të drejtë dhe të rregullt, pa marrë në shqyrtim një ose disa pretendime të tjera për shkeljen disiplinore ndaj të njëjtit magjistrat, ka të drejtë: a) të urdhërojë Inspektorin e Lartë të Drejtësisë të ndryshojë ose të shtojë objektin e procedimit disiplinor, në përputhje me këtë ligj, si dhe të hetojë këto pretendime të tjera të paktën brenda afatit njëmuajor; b) të vendosë mbi pretendimet e ndryshuara ose të shtuara, nëse nuk është i nevojshëm hetim i mëtejshëm, pasi të ketë dëgjuar palët në procedim. 2. Inspektori i Lartë i Drejtësisë vepron sipas parashikimeve të pikës 1, të nenit 136, të këtij ligji”.

¹³ Neni 140 i Ligjit për Statusin, titulluar “Bashkimi i procedimeve disiplinore”, parashikon se: “1. Kur Këshilli konstaton që procedimi disiplinor u referohet të njëjtave fakte dhe të njëjtit magjistrat, mund të vendosë bashkimin e procedimeve. ...”.

47. Pra, ligji bazë për përgjegjësinë disiplinore të magjistratit, tek i cili mbështet qëndrimin e tij dhe Inspektori i Lartë i Drejtësisë, lidhur me pamundësinë e pezullimit të procedimit disiplinor, nuk pranon ekzistencën në të njëjtën kohë të disa procedimeve disiplinore ndaj një magjistrati. Ndaj, për zbatimin strikt të këtij ligji (Ligjit për Statusin), do të duhej që të gjitha faktet të atribuuar si shkelje disiplinore magjistratit në fjalë, të shqyrtoheshin në një procedim disiplinor të vetëm. Por një gjë e tillë, sikurse më lart u përmend, është e pamundur ligjërisht pasi, sipas legjislacionit në fuqi, procesi i rivlerësimit kalimtar dhe procedimi disiplinor sipas Ligjit për Statusin, janë dy procese të pavarura nga njëri tjetri, që zhvillohen nga organe të ndryshme, të pavarura dhe sipas procedurave jo të njëjta.

48. Në këto kushte, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se zbatimi i legjislacionit në fuqi për përgjegjësinë disiplinore të magjistratëve kërkon, nga njëra anë, pranimin e realiteteve kushtetuese, ligjore dhe faktike dhe, nga ana tjetër, adresimin e tyre në mënyrë efektive dhe efikase për qëllimin e zbatimit të saj, pikërisht zbatimin kur është rasti të sanksioneve disiplinore me qëllim rritjen e përgjegjshmërisë së magjistratit në ushtrimin e funksionit në të ardhmen.

49. Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se qëllimi i nenit 126, pika 1, të Ligjit për Statusin është dhënia përparësi e proceseve të tjera ligjore ndaj magjistratit në raport me procedimin disiplinor, duke kushtëzuar këtë të fundit me përfundimet e tyre, sa kohë ato kanë lidhje dhe ndikim të drejtpërdrejtë në këtë të fundit. Dhe në rastin konkret është e dukshme se mënyra e përfundimit të procesit të rivlerësimit kalimtar ndaj znj. {...}, ka ndikim të drejtpërdrejtë dhe kushtëzon vijimin e procedimit disiplinor ndaj tij, në harmoni dhe me përcaktimin e nenit 66 të Kodit të Procedurave Administrative, Kod i cili është i detyrueshëm për t'u zbatuar nga Këshilli (neni 97, pika 3, i Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar), duke përligjur pezullimin e këtij procedimi disiplinor.

50. Në këto kushte, ndërsa aktualisht është vënë në diskutim dhe është pranuar ekzistenca e një shkakut kushtetues për mbarimin e statusit të magjistratit për znj. {...}, në kushtet kur ai është "*Shkarkuar nga detyra*" nga organi disiplinor i rivlerësimit kalimtar dhe çështja e rivlerësimit mund të shkojë për shqyrtim përpara organit më të lartë të rivlerësimit, Këshilli vlerëson se një rrethanë e tillë përbën shkak që, bazuar në nenin 145 të Ligjit për Statusin dhe nenin 66 të Kodit të Procedurave Administrative, të vendoset pezullimi i shqyrtimit të procedimit disiplinor të filluar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, deri në përfundim të çështjes së rivlerësimit, pasi mbajtja ose jo e statusit të magjistratit nga ai, në kuptim të Ligjit për Statusin, përbën parakusht për shqyrtimin në themel të procedimit disiplinor ndaj tij, në kushtet kur shkarkimi nga detyra e magjistratit, sikurse më lart u parashtrua, përbën një nga rastet e mbylljes së procedimit disiplinor. Nga ana tjetër, marrja nga Kolegji i Posaçëm i Apelit të një vendimi për prishjen e vendimit të shkarkimit nga detyra të magjistratit, në eventualitetin e ankimimit të tij, janë kushtet ligjore për rënien e shkakut të pezullimit të procedurës së shqyrtimit disiplinor dhe rifillimin e saj.

51. Këshilli vlerëson se pikërisht pezullimi i procedimit disiplinor, siç paraqitet në rastin konkret, nuk pengon shqyrtimin e tij në një kohë të mëvonshme (me rënien e shkakut të pezullimit), nëse nuk do të verifikohet rasti i mbylljes së tij (mbarimi i statusit të magjistratit për znj. {...} për shkak të “*shkarkimit nga detyra*” me vendim përfundimtar në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar). Pra, ky pezullim nuk sjell asnjë pasojë negative për procedimin disiplinor dhe as pengon shqyrtimin e tij nëse plotësohet kërkesa e ligjës, pikërisht qartësimi i rrethanës të vijimit të mbajtjes nga gjyqtari i proceduar disiplinarisht të statusit të magjistratit. Nga ana tjetër, vlen të përmendet se vijimi i shqyrtimit të këtij procedimi disiplinor, sikurse kërkohet nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, edhe në supozimin e pranimit të kërkesës së tij për ekzistencën e shkeljes disiplinore dhe vendosjes së sanksionit të propozuar ndaj magjistratit, nuk krijon asnjë impakt në këtë rast dhe, aq më pak, impaktin e pritshëm ligjor. Në këtë rast, impakti në realitet, është se tashmë magjistrati është nën një efekt pezullues, pikërisht, për shkak të vendimit të organit të rivlerësimit dhe ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (neni 62).

52. Lidhur me koherencën në qëndrimet e tij, vlen të përmendet se në procedime disiplinore të mëparshme¹⁴, ku magjistratët janë vënë para përgjegjësisë disiplinore dhe nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë është kërkuar “*Shkarkimi nga detyra*” për shkak të vërtetimit të një shkakut të përcaktuar shprehimisht në Kushtetutë¹⁵, pikërisht “*dënimi me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi*”, Këshilli ka operuar me shqyrtimin e procedimeve disiplinore dhe sanksionimin e magjistratëve me këtë masë. Në këto raste, magjistratët kanë qenë në proces rivlerësimi, por ky proces për ata nuk kishte përfunduar. E përveç kësaj, ajo çka është më e rëndësishme, Këshilli ka vlerësuar se vërtetimi në ato raste i ekzistencës së një shkakut kushtetues për “*Shkarkimin nga detyra*” të magjistratëve, nuk mund të pengonte zhvillimin e procedimit disiplinor ndaj tyre. Ngritja në rang kushtetues të këtij shkakut dhe parashikimi nga vetë Kushtetuta edhe të sanksionit disiplinor imponon pa ekuivok ushtrimin nga Këshilli i Lartë Gjyqësor të funksionit kushtetues disiplinor¹⁶, përderisa kushtetutëbërësi i ka dhënë të njëjtën rëndësi shkaqeve dhe sanksioneve disiplinore të parashikuara shprehimisht në Kushtetutë, e cila në këto raste është e zbatueshme dhe drejtpërdrejtë. Ndërkohë, rasti në shqyrtim nuk është i tillë.

53. Po ashtu, vlen të përmendet edhe se në procedime disiplinore të mëparshme¹⁷, ku magjistratët janë vënë para përgjegjësisë disiplinore dhe nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë është kërkuar vendosja e një sanksioni disiplinor për shkak të vërtetimit të një shkakut të përcaktuar nga Ligji për Statusin, Këshilli ka operuar me shqyrtimin e procedimeve disiplinore dhe, kur ka qenë rasti, me vendosjen e sanksioneve disiplinore sipas ligjit, ndërsa

¹⁴ Procedimet disiplinore ndaj magjistratëve Shkëlqim Miri, Kliton Spahiu dhe Roland Hysi.

¹⁵ Sipas nenit 140 të Kushtetutës: “2. Gjyqtari shkarkohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor kur: ...; b) është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi. ...”.

¹⁶ Sipas nenit 147/a të Kushtetutës: “1. Këshilli i Lartë Gjyqësor ushtron funksionet e mëposhtme: ...; b) vendos për masat disiplinore ndaj gjyqtarëve të të gjitha niveleve; ...”.

¹⁷ Procedimet disiplinore ndaj magjistratëve Markelian Kuqo, Enkeleida {...}, Enkeleida Kapedani dhe Hektor Sinanaj, Taulant Tafa.

magjistratët në këto raste kanë qenë në proces rivlerësimi, por ky proces për ata nuk kishte përfunduar, pra ata vijonin të ushtronin detyrën. Ndërkohë, rasti në shqyrtim, sikurse më lart u parashtrua, nuk është i tillë dhe Këshilli ka operuar me pezullimin e procedimeve disiplinore deri në përfundim të procesit të rivlerësimit ndaj magjistratëve subjekt të procedimit¹⁸.

54. Së fundi, referuar pikës 6, të nenit 126, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: “6. *Vendimi për pezullimin e hetimit nuk ankimohet*”, në lidhje me përcaktimin e nenit 145, të këtij ligji, sipas të cilit parashikimet e nenit 126, aplikohen për aq sa gjejnë zbatim edhe për procedimet disiplinore, Këshilli vëren se ligji iu ka kufizuar subjekteve të procedimit disiplinor të drejtën e ankimit në gjykatë ndaj vendimit të pezullimit të procedimit disiplinor, pra ndaj këtij vendimi nuk lejohet ankim.

PËR KËTO ARSYE

Mbështetur në nenin 145, në lidhje me nenin 126, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 97, pika 1, shkronja “a” dhe pika 3, i Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe në nenin 66 të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

V E N D O S I:

1. Pezullimin e procedimit disiplinor nr. 1/2024 të filluar ndaj magjistrates znj. {...}, me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, deri në marrjen formë të prerë të vendimit nr. 437 datë 10.09.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
2. Kundër këtij vendimi ligji nuk lejon ankim.
3. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet subjektit të procedimit disiplinor, magjistrates znj. {...} dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

¹⁸ Procedimet disiplinore ndaj magjistratëve Bevis Shehaj, Bujar Musta, Ramazan Avdiu, Sami Ujkashi, Ken Dhima.